

LIGJ
Nr.9327, datë 6.12.2004

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8978, DATË 12.12.2002 “PËR TAKSËN VENDORE
MBI BIZNESIN E VOGËL”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8978, datë 12.12.2002 “Për taksën vendore mbi biznesin e vogël”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 4 “Organi tatimor” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4
Organi tatimor

Organe tatimore për mbledhjen e kësaj takse janë degët e tatimeve, me përjashtim të rasteve kur Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor e Decentralizimit, si dhe mbi bazën e kërkesës së organeve të pushtetit vendor, cakton organ tjetër tatimor.”.

Neni 2

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, pas shkronjës "a" shtohet shkronja "a/1" me këtë përmbajtje:
"a/1) duke filluar nga 1 janari 2006 regjistrimi për herë të parë i tatimpaguesve bëhet pasi ata të jenë pajisur me leje për ushtrim veprimtarie nga organet e pushtetit vendor.
Kriteret për dhënien e lejeve për ushtrim të veprimtarisë së biznesit të vogël nga organet e pushtetit vendor përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.
2. Shkronja "b" e pikës 7 shfuqizohet.

Neni 3

Neni 9 “Pagesa” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9
Pagesa

1. Tatimi paguhet në dy këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill, ndërsa kësti i dytë paguhet jo më vonë se data 20 tetor.
2. Kur tatimpaguesi e fillon veprimtarinë gjatë vitit, tatimi paguhet për muajt efektivë të punës, në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.
3. Nëse tatimpaguesi paguan shumën e plotë të tatimit vjetor para datës 1 shkurt, shuma e detyrimit tatimor zvogëlohet me 5 për qind dhe nëse tatimpaguesi paguan shumën e plotë të tatimit para datës 1 mars, shuma e detyrimit tatimor zvogëlohet me 3 për qind.

4. Nëse organi tatimor përgjegjës zbulon se tatimpaguesi ka dhënë të dhëna të pasakta në çastin e regjistrimit dhe shuma fikse për t'u paguar është më e madhe se shuma e paguar, ai, sipas rastit, duhet të njoftojë tatimpaguesin. Tatimpaguesi paguan detyrimin tatimor shtesë brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit.

5. Tatimi paguhet në mënyrën dhe vendin e përcaktuar në udhëzim.

6. Kur një biznes mbyllet gjatë vitit dhe vlera e detyrimit tatimor të llogaritur në përputhje me pikën 5 të nenit 3 të këtij ligji është më e vogël se tatimi i paguar, diferenca i kthehet tatimpaguesit brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për mbylljen e biznesit.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4431, datë 17.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu